

JETËSHKRIM

Naureda Adnan Llagami
2024

1. TË DHËNAT PERSONALE

Nr. Personal i kartës së identitetit: [REDAKTUAR]
Datëlindja: 17/12/1978
Vendlindja: Tiranë, Shqipëri;
Adresa: Rruga 'Him Kollit' [REDAKTUAR] Tiranë; Shqipëri;
Tel/Cel: 068 [REDAKTUAR]
Adresa Elektronike: [REDAKTUAR]@gmail.com;

2. TË DHËNA PËR PËRVOJËN PROFESIONALE

Periudha Dhjetor 2018 – Tetor 2024 **Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësorë, nga radhët e shoqërisë civile, zgjedhur nga Kuvendi, me mandat 5 vjeçar, me kompetencat e mëposhtme:**

- a) Përgjegjëse për mirëfunksionimin e Këshillit dhe zbatimin me efikasitet të detyrave të tij në përputhje me ligjin;
- b) Përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet plenare të Këshillit; në këto mbledhje janë miratuar **3423 akte** që adresojnë çështjet të ndryshme në sistemin e drejtësisë.
- c) Drejton, mbikëqyr dhe koordinon veprimtarinë e administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të përbërë nga një staf prej 128 punonjësish;
- d) Përfaqëson Këshillin në marrëdhënien me të tretët, përfshirë trupin diplomatik, organizatat dhe partnerët ndërkombëtar brenda dhe jashtë vendit ;
- e) Siguron bashkëpunimin me institucionet e tjera;
- f) Raporton para Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor dhe buxhetin, dhe merr masat për publikimin e raportit;
- g) Propozon kryetarët e komisioneve të përhershme dhe cakton kryetarët e komisioneve të përkohshme të Këshillit;

Kryetare e Komisionit të Planifikimi Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, kam drejtuar punën, duke miratuar deri në fund të shtator 2024, 470 akte, ndër më të rëndësishmet si më poshtë vijon:

- h) Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik 2019-2021, dhe 2022-2024 në përputhje me objektivat e ligjit "Për Qeverisjen" dhe koordinimin me strategjinë e ndër sektoriale të drejtësisë;
- i) Hartimin dhe prezantimin përpara Kuvendit të raportit vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, në koordinimin me komisionet e tjera, i cili përshkruan krahas veprimtarisë së Këshillit dhe Komisioneve të tij, nivelin e

efiçencës dhe cilësisë së drejtësisë që jepet në gjykatat e vendit sipas indikatorëve të performancës të raportuara nga vetë gjykatat. Gjithashtu, ky raport përmban një set rekomandimesh për përmirësimet e nevojshme në sistemin gjyqësor;

- j) Hartimin e akteve nënligjore, si dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor;
- k) Verifikimin e kushteve formale dhe kritereve ligjore për kandidatët për ndihmës ligjor, këshilltar ligjor dhe kancelarë;
- l) Mirë-administrimin e pasurive të paluajtshme të gjykatave në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe këshillin e gjykatës;
- m) Administrimin e sistemit të arkivimit gjyqësor, si dhe menaxhimin dhe administrimin e tij;
- n) Hartimin dhe propozimin e projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm të Këshillit, në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave, si dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë.
- o) Person kyç në hartimin dhe propozimin për hartën e re gjyqësore nga grupi ndërinstitucional i punës, në negociata me Ministrinë e Drejtësisë dhe zhvillimin e procesit të konsultimit publik me të gjithë aktorët, deri në miratimin dhe zbatimin e saj;
- p) Person kyç për koordinimin e donatorëve/partnerëve dhe mbështetjen e tyre ndaj KLGG-së dhe sistemit gjyqësor; Ngritjen e fondeve për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore me donatore si EU dhe Ambasada Suedeze në vlerën **9.5 milion euro**;
- q) Person përgjegjës për hartimin e propozimit “Për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”, hartuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar. Ky propozim mban parasysh si përshkallëzimin ashtu dhe proporcionalitetin e tarifave gjyqësore sipas shkallëve të gjykimit, garanton cilësinë e shërbimeve gjyqësore dhe siguron aksesin e qytetarëve në drejtësi, veçanërisht për shtresat në nevojë.
- r) Person përgjegjës në hartimin e një pakete aktesh nënligjore, përmes të cilave nisi procesi i reformës së administratës gjyqësore. Ky është një proces transformimi i plotë, në funksion të garantimit të një administrate gjyqësore sa më profesionale, të qëndrueshme dhe me integritet të lartë në ushtrimin e funksioneve publike;
- s) Hartuese e kurrikulave të nëpunësve civil gjyqësor, lidhur me trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm, dhe kuadrit nënligjor për zhvillimin e këtyre trajnimeve. Pilotimi i tyre nëpër gjykata;
- t) Person kyç në hartimin dhe zbatimin e sondazhit për matjen e cilësisë së shërbimit në gjykata nga përdoruesit e gjykatave në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës 2021, vendi i parë në rajon;

Të tjera:

- a) Anëtare e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, që nga Janari 2019 deri në Tetor 2024;

- b) Përfaqësuese e KLGJ-së në Rrjetin Evropian të Këshillave Gjyqësor (ENCJ) që nga 2019;
- c) Përfaqësuese e Shqipërisë në Shoqatën Ndërkombëtare të Administratorëve të Gjykatave (International Association for Court Administrator IACA) që nga Korriku 2019;
- d) Kryetare e Bordit të Qendrës së Teknologjisë, nga janari 2021 deri në Tetor 2024, duke bërë të mundur ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të QTI, si dhe deri më sot janë miratuar nga kjo Qendër mbi 45 akte që rregullojnë çështjet e sistemeve teknologjike për të gjithë institucionet e drejtësisë; <https://klgj.al/qendra-e-teknologjise-se-informacionit-per-sistemin-e-drejtësisë/>

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria: Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit: Rr. “Ana Komnena”, Poli i Drejtësisë; <https://klgj.al/>

Periudha Maj 2016 – Dhjetor 2018 **Konsulente/Eksperte për Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri; EURALIUS IV, Ambasadën Britanike; OSBE, Këshillin e Evropës, TLAS, etj (e vetëpunësuar si person fizik me NIPT L62108011K;**

- a) Eksperte vendase për hartimin e projekt-rregulloreve të brendshme të gjykatave sipas kuadrit të ri ligjor në bashkëpunim me ekspertin britanik (Ambasada Britanike dhe EURALIUS VI 2017-2018), (bashkëlidhur kontrata e shërbimit);
- b) Eksperte vendase për hartimin e projektligjit për shërbimin e provës (Ambasada Britanike 2018), (bashkëlidhur kontrata e shërbimit);
- c) Eksperte vendase për hartimi e raportit vlerësues të Gjykatës së Krimeve të Rënda (Ambasada Britanike 2017), (bashkëlidhur kontrata e shërbimit);
- d) Eksperte vendase për hartimin e Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore (Euralius IV 2016), (bashkëlidhur kontrata e shërbimit);
- e) Dhënia e opinioneve ligjore subjekteve private dhe publike në çështjet e zbatimit të ligjit dhe ndërmarrja e iniciativave ligjore për to;
- f) Monitorim, pune kërkimore, analiza legjislacioni dhe raportim mbi zhvillimet legjislative dhe iniciativat institucionale në fushat e shtetit ligjor dhe të drejtave të njeriut për llogari të delegacionit të BE në periudhën 2014-2016; (kontrata kuadër bashkëlidhur).

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria: Person fizik me nr.NIPT L62108011K (e vetëpunësuar);

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit: Rruga Him Kolli, Tiranë;

Dhjetor 2012- Prill 2016

**Ndihmëse Ligjore pranë Kolegjit Civil/
Administrativ në Gjykatën e Lartë me këto
kompetenca:**

- a) Studimi i ankimeve, rekurseve dhe dosjeve gjyqësore;
- b) Përgatitja e relacioneve për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin ligjor mbi zgjidhjen e tyre;
- c) Përgatitja e projekt - vendimeve për çështjet gjyqësore;
- d) Hartimi i materialeve të nevojshme që i kërkohen gjyqtarit;
- e) Kryerja e kërtimeve ligjore që kërkohen për dosjet gjyqësore;

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria: Gjykata e Lartë;

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit: Rr. "Ibrahim Rugova"
Tiranë, Shqipëri; www.gjykataelarte.gov.al;

Periudha Prill 2012- Dhjetor 2012 **Konsulente (me kohë të pjesshme) në Projektin
“Mbështetje e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit
Prokurorial të Kosovës” financuar nga Zyra e
Delegacionit Evropian në Kosovë;**

- a) Analizimi i kuadrit ligjor ekzistues duke përfshirë ligjet dhe aktet nënligjore lidhur me organizimin dhe funksionimin e të dy këshillave;
- b) Përgatitja e propozimeve ligjore, administrative dhe institucionale për përmirësim të parametrave lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të dy këshillave;
- c) Analizimi i kuadrit ligjor lidhur me emërimin, transferimin dhe promovimin e gjyqtarëve;
- d) Hartimi i propozimeve ligjore për përmirësime të procedurave të emërimit, transferimit dhe promovimit të gjyqtarëve;
- e) Dhënia e rekomandimeve për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm vlerësimi bazuar në parametra sa më objektive lidhur me matjen e performancës së gjyqtarëve;
- f) Vlerësimi i aksesit në drejtësi dhe përgatitja e rekomandimeve për një përmirësim të mëtejshëm të aksesit të publikut në drejtësi.

Periudha Qershor 2012 – Prill 2013

**Këshilltare për Barazinë Gjinore pranë
Ministrit të Drejtësisë në Shqipëri (me
kohë të pjesshme) në projektin “Ngritja e
kapaciteteve për integrimin e çështjeve të
barazisë gjinore” financuar nga
UNWOMEN;**

- a) Ofrimi i ekspertizës teknike Ministrit të Drejtësisë dhe institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë lidhur me mënyrën se si duhen integruar prioritetet e barazisë gjinore në politikat, programet dhe ligjet që hartohen nga kjo ministri;

- b) Mbështetje Ministrisë së Drejtësisë duke i siguruar burime teknike dhe financiare në realizimin e angazhimeve për barazinë gjinore;
- c) Rishikimi dhe propozimi i ndërhyrjeve në legjislacionin aktual duke përgatitur analiza për çështjet e barazisë gjinore lidhur me projekt-aktet ligjore dhe programet sektoriale në Ministrinë e Drejtësisë;
- d) Mbështetje Ministrisë së Drejtësisë në kërkimin e iniciativave dhe studimeve lidhur me çështjet e barazisë gjinore, ose në bashkëpunim me institucionet e tjera, si shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare;

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria: Ministria e Drejtësisë;

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit: Bulevardi “Zog I – rë”;
<https://www.drejtesia.gov.al>;

Periudha Shkurt 2010-Gusht 2011 **Drejtoresia e Drejtësisë së Hartimit dhe Përafrimit të Legjislacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë me kompetencat e mëposhtme:**

- a) Drejtimi, mbikëqyrja dhe koordinimi i veprimtarisë së administratës së Drejtësisë, përbërë nga 3 sektorë dhe 11 punonjës;
- b) Hartimi i projektligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e drejtësisë ose në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë;
- c) Përgatitja e mendimeve juridike për projektligjet dhe projekt-aktet e tjera normative të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe institucioneve qendrore, si dhe për marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave;
- d) Përgatitja, ndjekja, realizimi i politikave dhe veprimtarive që lidhen me hartimin e studimeve në fushën e legjislacionit për drejtësinë, kryerja dhe përfundimi i analizave tekniko-ligjore të vlerësimit, të efektivitetit të legjislacionit, të procesit legjislativ, si dhe metodologjisë dhe teknikës së hartimit të legjislacionit, harmonizimin tekniko-ligjor të brendshëm të legjislacionit;
- e) Ndjekja dhe realizimi i politikave dhe veprimtarive, që lidhen me çështjet e përfaqësjes dhe të integritetit të sistemit të drejtësisë në nismat dhe strukturat ndërkombëtare përkatëse, si dhe bashkërendimin e punës me institucionet e tjera, në funksion të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Komunitetit Evropian dhe të shteteve anëtare të tij;
- f) Përfaqësimi i Këshillit të Ministrave në komisionet parlamentare në rastet e shqyrtimit të legjislacionit të hartuar nga Ministria e Drejtësisë;
- g) Kontribut në hartimin e përgjigjeve të pyetësorit të Komisionit Evropian kryesisht lidhur me kapitullin 23 “*Të drejtat e njeriut*” si dhe në vijimësi si person përgjegjës për raportimet mbi kapitullin 23 përgjatë procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, si dhe në mekanizma të tjerë ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, etj.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria: Ministria e Drejtësisë;

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit: Bulevardi "Zog I – rë"; <https://www.drejtesia.gov.al>;

Periudha Dhjetor 2001- Shkurt 2010 **Këshilltare/Avokat pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS);**

- a) Ofrimi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore në çështjet civile/administrative për njerëzit në nevojë (grupet vulnerabël dhe të marginalizuar) duke i ndihmuar ato në adresimin e të drejtave të tyre sociale dhe ligjore përmes:
 - Përgatitjes së dokumenteve ligjore;
 - Kërkimeve ligjore dhe ofrimit të mendimeve ligjore për çështje të ndryshme;
 - Përfaqësimit të klientëve përpara organeve administrative dhe ato gjyqësore si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Lartë;
- b) Identifikimi dhe raportimi i problemeve ligjore të klientëve;
- c) Hartimi i raporteve të monitorimit mbi zbatueshmërinë e ligjit për grupet në nevojë.
- d) Kryerja e aktiviteteve lobuese për përmirësimin e legjislacionit ekzistues me qëllim garantimin e barazisë sociale për grupet në nevojë;
- e) Takime me komunitete vulnerabël (si komunitet Rome, gra të dhunuara, të mitur) për ti ndërgjegjësuar mbi të drejtat e tyre;

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS);

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit: Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet Agimi, Shk.18, Ap.322, Tiranë Shqipëri; <https://tlas.org.al/>;

3. ARSIMIMI, KUALIFIKIMET, TRAJNIMET DHE TITUJT PROFESIONALË

3.1 ARSIMIMI

Periudha: 1997- 2001

Diploma/Titulli i fituar: Jurist

Rezultati/Nota Mesatare: 9.5

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;

3.2 KUALIFIKIMET PASUNIVERSITARE

Periudha: 2004-2006

Diploma/Titulli i kualifikimit të fituar: Master në Studime Evropiane

Rezultati/Nota Mesatare: 8.8

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: SHPU (Universiteti i Tiranës)

Periudha: 2021-në vazhdim

Kandidate për gradën shkencore **Doktor**, me temë “*Vështrim krahasues i administrimit të gjyqësorit në Shqipëri në këndvështrim krahasues*” 2021- në vazhdim;

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Departamenti i së Drejtës Publike; Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;

3.3 TRAJNIME

- Kurs intensiv në College of Advocacy për Shërbimet Ligjore Falas (Legal Aid), **Instituti Benchmark, San Francisko, Kaliforni, USA** (2002).
- Kurs tre javor “*The Regional Advanced Programme on Human Rights*” organizuar nga **Raoul Wallenberg Institute – Lund University, Suedi** (2004).
- Kurs trajnimi mbi “*European System of Human Rights Protection*”- organizuar nga **Europa-Universitaet Viadrina Frankfurt (Oder), Gjermani** (2005).
- Kurs trajnimi nga Këshilli i Evropës për administrimin e gjykatave, **Dijon, Francë** (2006).
- Trajnim mbi “*Procedurat përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*”, organizuar nga **ERA, Strasburg, Francë** (2009).
- Kurs trajnimi 3 javor “*Për fuqizimin e administrimit të drejtësisë*”, organizuar nga Asser Institute **Hagë, Holandë** (2013).
- Trajnim në **Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut**, në kuadër të programit të Këshillit të Evropës CEPEJ mbi efikasitetin e gjykatave, për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së dhe standardeve të vendosura prej tyre në praktikën gjyqësore shqiptare (2014).
- Kurs trajnimi për shkrimin ligjor në **Universitetin e Tulan, New Orleans, USA** (2019).

3.5 TITUJ PROFESIONAL

Licencuar si avokat nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në 2002;

4. VEPRIMTARI AKADAMIKE /PROFESIONALE

- a) **Folëse** në konferencën e Organizatës Ndërkombëtare për Administrimin Gjyqësor, shtator 2019, në Nur-Sultan, të Kazakistanit me temën: “*Mundësitë dhe Sfidat e Gjykatave në Botë*”, <https://klgj.al/2019/09/kryetarja-e-keshillit-te-larte-gjyqesor-znj-naureda-llagami-po-merr-pjese-ne-konferencen-e-organizates-nderkombetare-peradministrimin-gjyqesor-e-cila-zhvillohet-ne-nur-sultan-te-kazakistanit-ne/>
- b) **Folëse** në konferencën evropiane drejtësia restauruese me temën: “*Roli i KLGJ-së në promovimin e drejtësisë restauruese për fëmijët*”;
- c) **Folëse** në tryezën ndërkombëtare me temën: “*Administrimi i gjykatave dhe statistikat si mjete strategjike për përmirësimin e performancës*”; (bashkëlidhur moduli i hartuar);
- d) **Folëse** në tryezën ndërkombëtare “*Kultura gjyqësore dhe vetëqeverisja*”, shtator 2021, Beograd; <https://idscs.org.mk/en/2021/09/28/judicial-culture-and-judicial-self-governance-discussed-at-experts-workshop-co-organised-by-idscs-and-cepris/> (bashkëlidhur tema e hartuar për këtë tryezë anglisht/shqip)
- e) **Folëse** në tryezën ndërkombëtare me temë “*Formësimi i Këshillave Gjyqësor për të përballuar sfidat bashkëkohore*”

- [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI\(2022\)008-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI(2022)008-e); mars 2022, Romë, Itali; (bashkëlidhur tema e hartuar për këtë tryezë anglisht/shqip);
- f) Folëse në Shkollën e Integrimit Evropian, 24 - 28 Tetor 2022, organizuar nga Këshilli i Integrimit në Kuvendin e Shqipërisë dhe Delegacioni i BE me temën “*Roli i drejtësisë në çështjet e integrimit të BE*”; (bashkëlidhur moduli i hartuar);
- g) Folesë në seminarin ndërkombëtar organizuar nga CCJE/ENCJ lidhur me “*Rastin/Modelin e procesit të rivlerësimit (vetting) në Shqipëri*” prill 2023; (bashkëlidhur tema për këtë seminar anglisht/shqip);
- h) Folëse në forumin ndërkombëtar organizuar nga OpenGovHub “*Reforma e drejtësisë në Shqipëri; Konstitucionalizmi në veprim*”; nëntor 2023, Washington DC, USA; <https://www.eventbrite.com/e/justice-reform-in-albania-constitutionalism-in-action-tickets-753320029487> (bashkëlidhur tema anglisht/ shqip);
- i) Pedagoge e jashtme e Shkollës së Magjistraturës nga 2019 e në vazhdim; (vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës);
- j) Eksperte e Shkollës së Magjistraturës për ndihmën juridike, të drejtën e pronës dhe këshillat e gjykatës (vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës);
- k) Lektore pranë Shkollës së Avokatisë për temën “*Gjykimi administrativ në shkallën e parë*” 2018;
- l) Lektore e së Drejtës Ndërkombëtare Private në ciklin e parë të studimeve pranë Universitet jo publik TBU 2011- 2013; (kontratë shërbimi) ;
- m) Lektore e së Drejtës Administrative në programin e studimit Diplomë e integruar e Nivelit të dytë të shkencave Juridike, si dhe në lëndën “*Parimet e përgjithshme të së drejtës*” në programin e studimit bachelor në Shkenca Politike në Universitet jo Publik “Albania University” gjatë viteve akademike 2008-2011; (vërtetim nga universiteti);
- n) Përfaqësues e Qeverisë Shqiptare në Konferencën e Palëve (COP), mekanizëm i cili vlerëson zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës “*Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit*” CETS N°198. ([www.coe.int/t/dghl/monitoring/cop198/.../C198-COP\(2011\)REP3_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/cop198/.../C198-COP(2011)REP3_en.pdf)) ;
- o) Lektore e së Drejtës Administrative në trajnimin për auditues i brendshëm në sektorin publik 2009 (kontratë shërbimi);
- p) Lektore e së Drejtës së Biznesit në ciklin e parë të studimeve pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës, 2006-2007;

5. PUBLIKIME PROFESIONALE DHE KËRKIME SHKENCORE

- a) **Publikimi i artikullit shkencor 2024:** “*Përdorimi i teknologjisë në sistemin gjyqësor*” <https://ejournals.org/gjplr/wp-content/uploads/sites/36/2024/07/The-Use-of-the-Technology-in-Justice-System.pdf>; (bashkëlidhur anglisht/shqip)
- b) **Publikimi i artikullit shkencor 2024:** “*Lidershipi në gjyqësor; Menaxhimi dhe rolet e administrimit në sistemin gjyqësor*”; <https://ejournals.org/gjplr/wp-content/uploads/sites/36/2024/04/Leadership-in-the-Judiciary.pdf>; (bashkëlidhur anglisht/shqip)

- c) **Bashkë autore e botimit “Portreti i gjyqtarit” 2024.** Ky botim është rezultat i një projekti kërkimor “*Portreti i një gjyqtari*” – një model shumëdimensional i aftësive që do të vlerësohen gjatë procedurave të përzgjedhjes, vlerësimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve financiar nga grantet e Islandës, Lihtenshtajnit dhe Norvegjisë përmes fondit të granteve të ZEE (Zonës Ekonomike Evropiane) dhe Norvegjisë; (bashkëlidhur një kopje e botimit);
- d) **Bashkë autore** për hartimin e Manualit “*Për të drejtën e pronësisë*”, të mbështetur nga Këshilli i Evropës 2017 (<https://rm.coe.int/training-manual-on-property-rights-eng/16808b7c6c>); (bashkëlidhur një kopje e manualit);
- e) **Eksperte për monitorimin** e rekomandimit të Opinionit të BE-së lidhur me të drejtat e njeriut dhe gjyqësorin. “*Monitorimi i planit të veprimit që adreson 12 rekomandimet e Opinionit të BE*” 2012 **SOROS/OSFA** (<https://www.osfa.al/publication/fondacioni-prezanton-raportin-qytetar-te-monitorimit-te-planit-te-veprimit-per-adresimin>);
- f) **Eksperte për hartimin** e raportit të monitorimit mbi qëndrueshmërinë e administratës publike për vitin 2009. Publikuar në mars 2010, nga Qendra Akses, financiar nga Ambasada Gjermane; (bashkëlidhur kopje), si dhe dhënia e komenteve dhe sugjerimeve për “*Planin e veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes transparente*”, Dhjetor 2011 (bashkëlidhur kopje);
- g) **Eksperte e TLAS** për hartimin e “*Raporti i monitorimit të zbatimit të ndryshimeve të ligjit “Për gjendjen civil” 2009*”, mbështetur nga UNICEF.
- h) **Eksperte/trajnere për hartimin** e moduleve lidhur me trajnimin për administratën gjyqësore në 10 gjykata pilot financiar nga USAID në 2010, (https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADW363.pdf);

6. QËNDRIMET PUBLIKE MBI PROBLEMATIKAT E GJYQËSORIT NË MEDIA.

- a) Datë 16.03.2021, intervistë për Zërin e Amerikës, [Kreu i KLGJ, Llagami: Me 4 kandidaturat e reja Gjykata e Lartë bëhet funksionale \(zeriamerikes.com\)](https://www.zeriamerikes.com);
- b) Datë 25.06.2021, intervistë për Report TV [Llagami për Report Tv: Brenda korrikut Gjykata e Lartë me 10 anëtarë! Sistemi në krizë \(youtube.com\)](https://www.youtube.com);
- c) Datë 01.01.2023, Intervistë për DW, [Shqipëri: Jo gjithmonë politika hesht, kur drejtësia flet – DW – 01/01/2023 \(ampproject.org\)](https://www.ampproject.org);
- d) Datë 30.01.2023, Intervistë për Top Channel, [Shkrirja e Apeleve/ Nga 1 shkurti](#)

vetëm Tirana me Gjykatë, Llagami jep DETAJE | Breaking Top News (youtube.com)

- e) Datë 13.05.2023, qëndrimi publik në MCN Gjykatat pa kryetarë, Llagami: Presim nga Parlamenti ndryshimet ligjore, nëse refuzon hapim garën në shtator (VIDEO) | MCN TV;
- f) Datë 23.06.2023, qëndrim publik për VisionPlus Faza e fundit e hartes se re gjyqesore, pritjet shkrirja e gjykatave administrative - Vizion Plus (youtube.com);
- g) Datë 17.07.2023, intervistë për RTSH 24 “Tirana, më problematikja”, Kryetarja e KLGJ: Stoku me dosjet e vjetra po ulet, ja sa vite duhen për gjykimin e një çështje | RTSH Lajme;
- h) Datë 13.07.2024, intervistë për “FactCheck” në MCN TV, FactCheck Drejtësia pa gjyqtarë dhe godina (youtube.com);
- i) Datë 26.09.2024, qëndrim publik në Report TV Kryetarja e KLGJ Llagami: Kuvendi nuk ka marr parasysh nismat tona! Bushka: Po punojmë - YouTube

7. TË TJERA

- ✓ Ish anëtare e Bordit të Qendrës për Dialog Social – qendër për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, themeluar dhe mbështetur nga Olaf Palme International Center – SIDA, Suedi;
- ✓ Ish anëtare e Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale, një organizatë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së grupeve vulnerabël të shoqërisë.

8. ZOTËRIMI I GJUHËVE TË HUAJA

Gjuha			
Aftësitë	Të kuptuarit	Të folurit	Shkrimi
Anglisht	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë
Italisht	Shume mirë	mirë	mirë

Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj: Dëshmi

Emri dhe lloji i institucionit që e ka lëshuar: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, 2003;

Çertifikata Aptis e lëshuar nga British Council 2022;